

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

“Studim projektim Lidhja midis qyteteve Roskovec - Lushnjë”

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur - Shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të konsulencës në projektim 79415200-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

1. Fondi limit: 24,003,310.28 (njëzet e katër milion e tre mijë e treqind e dhjetë pikë njëzet e tetë) **Lekë pa TVSH;**

Në Euro: 253,681.14 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një pikë katërbëdhjetë) **Euro pa TVSH.**

Në bazë të *Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024, Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:*

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitet 2026-2028, për Autoritetin Rrugor Shqiptar sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026.

Bazuar në *Nenin 42, pika 1 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (e ndryshuar) “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”*. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Nëse objekti do ndahej në lote, studim projektimi do të bëhej pothuajse i pamundur për shkak se është i njëjti aks, për më tepër në Termat e Referencës është i gjithë përshkrimi.

Gjithashtu, ndarja në lote e objektit do të komplikonte afatin e dorëzimit të projektit dhe do sillte vonesa për fillimin e zbatimit të punimeve ndërtimore.

Në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në një gazetë zyrtare të Bashkimit Europian.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë (Data 18.06.2026, ora 12:17:45)

1 Lek = 94.62 Euro

✓ Në DST është përcaktuar:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti / enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (shërbime të ngjashme):
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

➤ **Në lidhje me pikën 2.16 të DST-ve argumentojmë:**

Objekti i procedurës së prokurimit është hartimi i studimit dhe projektit të një aksi rrugor, i cili përbën një shërbim me natyrë kryesisht intelektuale, profesionale dhe këshilluese. Cilësia e

realizimit të kontratës lidhet drejtpërdrejt me eksperiencën, organizimin profesional dhe përgjegjësinë teknike të operatorit ekonomik që do të kryejë shërbimin.

Për këtë arsye, përvoja në shërbime të ngjashme duhet të zotërohet drejtpërdrejt nga ofertuesi. Përvoja në projektim nuk përfaqëson thjesht një burim teknik që mund të vihet në dispozicion nga një subjekt i tretë, por konsiston në njohuri profesionale, metodologji pune dhe ekspertizë të konsoliduar, të fituar nga vetë operatori ekonomik gjatë realizimit të kontratave të ngjashme. Mbështetja në përvojën e një subjekti tjetër nuk garanton transferimin efektiv të kësaj eksperience gjatë zbatimit të kontratës.

Njëkohësisht, licenca profesionale e projektimit është e lidhur ngushtë me subjektin që ushtron veprimtarinë dhe përbën një autorizim ligjor për ofrimin e shërbimeve të projektimit në kategoritë përkatëse. Duke qenë se objekti i kontratës është vetë shërbimi i projektimit, operatori ekonomik që merr përsipër realizimin e kontratës duhet të disponojë drejtpërdrejt licencën e kërkuar dhe kategoritë përkatëse të saj.

Kërkesa që ofertuesi të zotërojë vetë përvojën e ngjashme dhe licencën profesionale është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi këto përbëjnë kapacitete thelbësore për realizimin e kontratës dhe synojnë garantimin e cilësisë së projektimit, përgjegjësisë profesionale dhe ekzekutimit korrekt të shërbimit.

✓ Në DST është përcaktuar:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi **pikët 50**

Propozimi Teknik **pikët 50**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit	Pikët
(i) Përvoja për Shërbime të Ngjashme të Konsulentit	[0-10]
Nënkriteret	
i/a Përvoja për punë të ngjashme	40-80%
Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.	
i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë	10-20%
Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.	
Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.	
(ii) Metodologjia e Propozuar	[20-30]
Nënkriteret	
ii/a. Përfaqsjë teknike dhe metodologjia	[20-30%]
ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	[30-40%]
ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]

ii/a. Përfaqsjë teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqsjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të

shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikdhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Staffi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

[20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| a- Kualifikim i përgjithshëm | [5-20%] |
| b- Eksperienca në fushën përkatëse | [30-80 %] |

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Argumentimi:

Në kuadër të procedurës së prokurimit me objekt: “**Studim projektim Lidhja midis qyteteve Roskovec - Lushnjë**”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave “**Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në raportin cilësi-çmim**”, me ndarje të peshës 50% për propozimin teknik dhe 50% për propozimin ekonomik.

Argumentimi teknik:

Objekti i kësaj kontrate përbën një shërbim konsulence me natyrë të theksuar intelektuale dhe teknike, i cili përfshin studime dhe analiza të specializuara si:

- studime topografike, gjeologjike dhe gjeoteknike;
- analiza të trafikut dhe sigurisë rrugore;
- projektim të alternativave teknike të aksit rrugor;
- vlerësim të ndikimeve mjedisore dhe sociale;
- përgatitje të dokumentacionit teknik dhe preventivave për zbatim.

Cilësia e produktit përfundimtar ka ndikim të drejtpërdrejtë në fazën e mëvonshme të zbatimit (ndërtimit), duke ndikuar në kostot e realizimit të projektit; sigurinë dhe funksionalitetin e infrastrukturës; qëndrueshmërinë teknike të zgjidhjeve të propozuara.

Për këtë arsye, vlerësimi i ofertave nuk mund të bazohet vetëm në elementin financiar, pasi një ofertë me çmim më të ulët nuk garanton domosdoshmërisht cilësi të mjaftueshme teknike dhe profesionale, dhe mund të sjellë risk për mangësi në studime dhe analiza; gabime projektimi; nevojë për rishikime gjatë fazës së zbatimit; rritje të kostove totale të investimit publik.

Për këto arsye, përfshirja e kriterëve teknike si metodologjia e propozuar, përvoja e operatorit ekonomik dhe kualifikimi i stafit kryesor është thelbësore për sigurimin e një projekti cilësor dhe të zbatueshëm.

2. Argumentimi ligjor:

Kriteri i përzgjedhjes është në përputhje me dispozitat e *Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilat parashikojnë përdorimin e kriterit **“oferta ekonomikisht më e favorshme”**, bazuar në raportin më të mirë midis cilësisë dhe kostos.

Për kontratat e shërbimeve të konsulencës dhe projektimit, ku elementi profesional dhe teknik ka rol dominues, legjislacioni lejon dhe rekomandon përdorimin e kriterëve që vlerësojnë:

- cilësinë teknike të ofertës;
- eksperiencën dhe kapacitetet profesionale të operatorit ekonomik;
- kualifikimet dhe eksperiencën e stafit kryesor;
- metodologjinë dhe planin e punës.

Kriteret e përcaktuara në këtë procedurë janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës; objektive, të matshme dhe të verifikueshme; të hartuara në mënyrë proporcionale; të publikuara paraprakisht në dokumentet e tenderit dhe në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe mosdiskriminimit.

3. Argumentimi për sa i përket vlerësimit përfundimtar (50% teknik / 50% ekonomik)

Pesha e barabartë midis propozimit teknik dhe atij ekonomik është përcaktuar për të siguruar një balancë të drejtë midis cilësisë së shërbimit dhe përdorimit me eficiencë të fondeve publike. Kjo qasje shmang dominimin e vetëm faktorit çmim në një shërbim me natyrë të theksuar teknike dhe profesionale, si dhe nxit konkurrencën e bazuar në cilësi dhe zgjidhje teknike të qëndrueshme.

Ky raport vlerësimi siguron që oferta fituese të përfaqësojë kombinimin më të mirë midis cilësisë teknike të projektit dhe kostos së arsyeshme për realizimin e shërbimit.

- ❖ Në përfundim, kriteri i përzgjedhjes “Oferta ekonomikisht më e favorshme” me peshë 50% teknik dhe 50% ekonomik konsiderohet i përshtatshëm për këtë procedurë, pasi siguron vlerësimin e plotë të elementeve cilësore dhe financiare të ofertës, në përputhje me natyrën e kontratës dhe kuadrin ligjor në fuqi, duke garantuar përdorimin efikas dhe transparent të fondeve publike.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

d. *Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barriera për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës 10

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 10 është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Argumentimi:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës, është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 43, pika 1 dhe 2, gërma “a”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter synon të verifikojë kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë për të realizuar kontratën objekt prokurimi dhe për të përballuar angazhimet financiare që lidhen me

ekzekutimin e saj. Duke qenë se objekti i kontratës konsiston në shërbime studim-projektimi, të cilat kërkojnë angazhim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore të specializuara dhe kapaciteteve profesionale, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatorët ekonomikë të provojnë një nivel të përshtatshëm aktiviteti ekonomik.

Vlera e kërkuar e xhiros është përcaktuar në masën 100% të vlerës së fondit limit, nivel i cili është më i ulët se kufiri maksimal i lejuar nga *Neni 43, pika 2, gërma "a", i VKM Nr. 285/2021*. Ky përcaktim respekton parimin e proporcionalitetit dhe synon të garantojë njëkohësisht pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe përzgjedhjen e operatorëve që disponojnë kapacitetin e nevojshëm financiar për realizimin me sukses të kontratës.

Dokumentacioni i kërkuar për vërtetimin e xhiros vjetore mbështetet në të dhënat financiare dhe tatimore të deklaruar nga operatorët ekonomikë në përputhje me *Ligjin Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*, *Ligjin Nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat"*, të ndryshuar, si dhe *Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 26, datë 08.09.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat"*, të ndryshuar, të cilat përcaktojnë mënyrën e deklarimit dhe raportimit të të dhënave financiare dhe tatimore të subjekteve ekonomike.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit Nr. 10 091, datë 5.3.2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, si dhe *Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar.

Ky kriter synon të verifikojë gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit konsiston në shërbime studim-projektimi me rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që operatorët pjesëmarrës disponojnë qëndrueshmëri financiare dhe kapacitet të mjaftueshëm ekonomik për realizimin e kontratës.

Kërkesa që bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos paraqesin raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të provuar një gjendje financiare të shëndoshë dhe për të minimizuar rrezikun e vështirësive financiare gjatë ekzekutimit të kontratës.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe kontabël në fuqi, referuar *Ligjit Nr. 9/2025 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 26, datë 08.09.2023, i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të cilat përcaktojnë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare vjetore.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40 % të vlerës** së fondit të limitit të kësaj kontrate realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në *Nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 41, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).*

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë realizuar me sukses gjatë tre viteve të fundit shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit është vendosur në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të kontratës, i cili konsiston në studimin dhe projektimin e aksit rrugor objekt kontrate.

Shërbimet e studim-projektimit përbëjnë veprimtari me natyrë intelektuale, profesionale dhe këshilluese, të cilat kërkojnë njohuri të specializuara, eksperiencë të provuar në projektimin e infrastrukturës rrugore, si dhe aftësi për koordinimin e disiplinave të ndryshme teknike të përfshira në procesin e projektimit. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që operatori ekonomik disponon eksperiencën e nevojshme dhe ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me sukses.

Niveli i kërkuar prej 40% të fondit limit është proporcional dhe i arsyeshëm, pasi garanton se operatori ekonomik ka kapacitetin profesional dhe organizativ për të përballuar realizimin e kontratës, pa krijuar kufizime të panevojshme për konkurrencën.

Ky kriter synon të minimizojë rrezikun e mosrealizimit ose realizimit me mangësi të shërbimit dhe të sigurojë cilësinë e produktit përfundimtar të projektimit.

Dokumentacioni i kërkuar për vërtetimin e përvojës së ngjashme është në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe synon të provojë në mënyrë objektive realizimin e shërbimeve, vlerën e tyre, afatin e ekzekutimit dhe përmbushjen me sukses të kontratave të mëparshme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar. Licenca profesionale e operatorëve ekonomikë e lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **1.b- 1.** Plane sektoriale në nivel qarku;
 - 2. Plane sektoriale në nivel bashkie.
- **2.b- 3.** Objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.
- **2.d-** Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.
- **3.c-1.** Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike -
 - 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

- **4.i-** Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.
- **5.d-** Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.
- **6.a-** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- **7.a-** Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.
- **7.b-** Ura dhe vepra arti mbi 10 m.
- **8.a-** Rivelime inxhinierike.
- **8.b-** Rilevime inxhinierike kadastrale.
- **8.d-** Bazamente gjeodezike.
- **8.e-** Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- **9.d-** Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- **9.e-** Studime e projektme hidrogeologjike.
- **10.e-** Kabina elektrike të rretit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.
- **11.a-** Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
- **11.b-** Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.
- **11.d-** Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.
- **12.a-** Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- **12.c-** Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj.

Shënim: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM-në Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për

licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit kompetent në Republikën e Shqipërisë, konform VKM-së Nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në *nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) , si dhe VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.*

Kategoritë e mësipërme të licencës përbëjnë provë të aftësisë profesionale dhe teknike të operatorit ekonomik për të kryer shërbime projektimi në këto kategori specifike dhe është e lidhur ngushtë me realizimin e objektit të kontratës. Kërkesa konsiderohet proporcionale, e domosdoshme dhe në funksion të garantimit të cilësisë së projektimit, sigurisë së veprave të projektuara dhe mbrojtjes së interesit publik.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me detyrat dhe objektivat e përshkuara te Termat e Referencës.

Konkretisht, argumentojmë si më poshtë:

- **1.b- 1. Plane sektoriale në nivel qarku;**

Objekti që do të projektohet përfshin qarkun e Fierit, i cili ka në përbërje Bashinë e Roskovecit dhe të Lushnjës, për këtë arsye është e domosdoshme që shoqëria projektuese të ketë në licencë kategorinë e përcaktuar.

- **2. Plane sektoriale në nivel bashkie.**

Objekti që do të projektohet lidh 2 (dy) bashki, atë të Roskovecit dhe atë të Lushnjës, për këtë arsye është e domosdoshme që shoqëria projektuese të ketë në licencë kategorinë e përcaktuar.

- **2.b- 3. Objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.**

Veprat e artit në infrastrukturë kërkojnë jo vetëm projektim strukturor, por edhe trajtim arkitektonik dhe estetik, me qëllim integrimin harmonik të tyre në territor. Për këtë arsye kërkohet pjesëmarrja e arkitektit të licencuar në kategorinë përkatëse.

- **2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.**

Veprat e artit në infrastrukturë përveç anës strukturore kanë nevojë edhe për anën estetike, ku bën pjesë arkitekti. Duke qënë se aksi kalon pranë zonave urbane, qendrave të banuara, nyjeve, shesheve apo hapësirave publike dhe projekti parashikon ndërhyrje në hapësira me ndikim të drejtpërdrejtë në peizazhin urban dhe mjedisin e ndërtuar, duke e bërë të domosdoshëm angazhimin e Inxhinierit të arkitekturës dhe peizazhit për garantimin e integritit urbanistik dhe estetik të veprës.

- **3.c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike**
- **2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.**

Për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të objektit të kontratës, i cili konsiston në studim-projektimin e një aksi rrugor interurban, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të disponojë licencën profesionale të projektimit në kategoritë 3.c-1 dhe 3.c-2.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me nevojën për projektimin e veprave të artit, strukturave mbajtëse dhe elementeve të tjerë konstruktivë që mund të parashikohen përgjatë trasesë së rrugës, si dhe me kushtet gjeoteknike të terrenit ku do të zhvillohet investimi. Projektimi i infrastrukturës rrugore kërkon vlerësimin e ndërveprimit strukturë–terren, analizën e stabilitetit të trojeve dhe shpateve, si dhe dimensionimin e strukturave beton arme dhe metalike në përputhje me normat teknike dhe kërkesat e sigurisë.

Për më tepër, prania e zonave me karakteristika gjeologjike dhe gjeoteknike të ndryshueshme mund të kërkojë projektimin e masave mbrojtëse dhe stabilizuese, mureve mbajtëse, veprave të artit dhe strukturave të tjera me shkallë të lartë vështirësie. Për këtë arsye, disponimi i këtyre kategorive të licencës përbën garanci se operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e projektit, në përputhje me kërkesat e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit afatgjatë të veprës.

Për këto arsye është e domosdoshme angazhimi i inxhinierëve të ndërtimit me kualifikimet dhe kompetencat profesionale përkatëse.

Për rrjedhojë, kërkesa konsiderohet e domosdoshme, e arsyeshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit dhe me kompleksitetin teknik të shërbimeve që do të realizohen.

- **4.i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.**

Duke qënë se aksi rrugor kalon në zona të banuara është e nevojshme përfshirja në licencën e projektuesit instalator për ndriçimin rrugor, sheshe, etj.

- **5.d- Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.**

Traseja kalon në zona fushore ku kërkohet projektimi i sistemit të drenazhimit dhe veprave të largimit të ujërave sipërfaqësore, përfshirë tombinot dhe veprat e kullimit, për garantimin e qëndrueshmërisë së trupit të rrugës.

- **6.a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.**

Sipas Rregullave të Projektimit të Rrugëve (2015), aksi klasifikohet si rrugë e kategorisë C3 (rrugë interurbane dytësore), ndaj kjo kategori licence është e domosdoshme.

- **7.a- Ura dhe vepra arti deri në 10 m.**
- **7.b- Ura dhe vepra arti mbi 10 m.**

Për shkak të karakteristikave të trasesë dhe ndërprerjeve hidraulike të mundshme, parashikohet nevoja për projektimin e urave dhe veprave të artit me hapësira si nën ashtu edhe mbi 10 m.

- **8.a- Rivelime inxhinierike.**
- **8.b- Rilevime inxhinierike kadastrale.**
- **8.d- Bazamente gjeodezike.**
- **8.e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik**

Këto kategori janë të nevojshme për realizimin e studimit topografik dhe gjeodezik të trasesë me saktësinë e kërkuar për projektimin e infrastrukturës rrugore.

- **9.d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.**
- **9.e- Studime e projektme hidrogeologjike.**

Prania e tokave aluvionale dhe niveleve të konsiderueshme të ujërave nëntokësore kërkon vlerësim të kushteve gjeologjike dhe hidrogeologjike për projektimin e sigurt të veprës.

- **10.e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.**

Për furnizimin me energji të sistemeve të ndriçimit rrugor dhe pajisjeve të infrastrukturës në nyjet rrugore, kërkohet projektimi i rrjeteve dhe kabinave elektrike përkatëse.

- **11.a-** Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
- **11.b-** Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.
- **11.d-** Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Sinjalistika horizontale, vertikale dhe ndriçuese përbën element të detyrueshëm të projektimit rrugor, në funksion të sigurisë dhe menaxhimit të trafikut.

- **12.a- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.**
- **12.c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte, etj.**

Projektimi i infrastrukturës rrugore, veçanërisht urave dhe veprave të artit, kërkon vlerësimin e veprimit sizmik dhe klasifikimin gjeosizmik të trojeve, në përputhje me kërkesat e normave teknike në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues teknik të shoqërisë, të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas objektit të kësaj kontrate, si më poshtë:

- Drejtues projekti (Inxhinier Ndërtimi) me eksperiencë profesionale jo më pak se 15 vite
- Inxhinier Mjedisi me eksperiencë jo më pak se 5 vite
- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist me eksperiencë profesionale jo më pak se 10 vite
- Inxhinier Elektrik me eksperiencë profesionale jo më pak se 7 vite
- Inxhinier Hidroteknik me eksperiencë profesionale jo më pak se 7 vite
- Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit me eksperiencë profesionale jo më pak se 10 vite
- Inxhinier Gjeoteknik me eksperiencë profesionale jo më pak se 10 vite
- Inxhinier Gjeodet / Inxhinier Topograf me eksperiencë profesionale jo më pak se 10 vite

- Inxhinier Gjeolog me eksperiencë profesionale jo më pak se 15 vite
- Inxhinier Mekanik me eksperiencë profesionale jo më pak se 7 vite
- Urbanist me eksperiencë profesionale jo më pak se 7 vite
- Arkitekt me eksperiencë profesionale jo më pak se 7 vite

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune, CV, si dhe licencat profesionale për projektim për objektin që prokurohet.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe Nenit 41, pika 4/b), e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrave dhe objektiva të përshkuara të Termat e Referencës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Vitet e kërkuara të eksperiencës nuk përbëjnë një kriter formal, por një tregues të nivelit të maturimit profesional dhe të aftësisë për të projektuar projektet infrastrukturore në mënyrë të sigurt dhe ekonomike. Sa më i madh të jetë ndikimi i një discipline në sigurinë strukturore, stabilitetin gjeoteknik, funksionalitetin ose koordinimin e projektit, aq më e lartë është eksperiencia e kërkuar. Për këtë arsye, profilet kyçe si Drejtuesi i Projektit, Gjeologu, Strukturisti, Gjeotekniku dhe Inxhinieri i Infrastrukturës së Transportit kërkojnë eksperiencë 10-15 vjeçare, ndërsa profilet mbështetëse dhe specializuese kërkojnë 5-7 vite eksperiencë, duke respektuar parimin e proporcionalitetit me objektin dhe kompleksitetin e kontratës.

Drejtues Projekti (Inxhinier Ndërtimi) – jo më pak se 15 vite eksperiencë

Kërkesa për jo më pak se 15 vite eksperiencë lidhet me faktin se drejtuesi i projektit është përgjegjës për koordinimin e të gjitha disiplinave teknike dhe për marrjen e vendimeve strategjike gjatë procesit të projektimit. Një profesionist me këtë nivel eksperience ka kaluar nëpër cikle të

ndryshme projektimi, zbatimi dhe menaxhimi kontratash, duke fituar aftësinë për të identifikuar problematika komplekse në fazat fillestare të projektimit. Përvoja jo më pak se 15 vite siguron njohuri të avancuara në menaxhimin e riskut teknik, optimizimin e kostove, koordinimin ndërdisiplinor dhe garantimin e cilësisë së dokumentacionit teknik.

Inxhinier Gjeolog – jo më pak se 15 vite eksperiencë

Gjeologjia përbën një nga faktorët më kritikë për suksesin e projekteve rrugore. Identifikimi i zonave me paqëndrueshmëri, rrëshqitje, apo fenomene të tjera kërkon eksperiencë të gjatë praktike. Shpesh problematikat gjeologjike nuk mund të identifikohen vetëm nga literatura apo analizat laboratorike, por kërkojnë njohuri të fituara nga rastet konkrete në terren. Për këtë arsye, eksperiencia jo më pak se 15 vite konsiderohet e nevojshme për të reduktuar rrezikun e zgjidhjeve të pasakta që mund të shkaktojnë pasoja të rënda teknike dhe ekonomike gjatë projektimit.

Inxhinier Strukturist – jo më pak se 10 vite eksperiencë

Projektimi i strukturave në veprat rrugore kërkon njohje të avancuar të sjelljes së materialeve, ngarkesave dinamike, efekteve sizmike dhe kushteve të ndryshme të terrenit. Një eksperiencë jo më pak se 10 vite garanton që Inxhinieri ka trajtuar një gamë të gjerë situatash projektuese dhe është në gjendje të zgjedhë zgjidhjen më të sigurt dhe ekonomikisht më të favorshme. Gjithashtu, eksperiencia e gjatë redukton probabilitetin e gabimeve në llogaritjet strukturore që mund të ndikojnë në sigurinë e veprës.

Inxhinier Infrastrukturë Transporti – jo më pak se 10 vite eksperiencë

Projektimi gjeometrik i rrugëve kërkon balancimin e shumë parametrave teknikë si siguria rrugore, karakteristikat e trafikut, kushtet topografike dhe kostot e ndërtimit. Një inxhinier me jo më pak se 10 vite eksperiencë ka përvojë të mjaftueshme për të analizuar alternativa të ndryshme të trasesë, për të optimizuar parametrat teknikë dhe për të shmangur problematika që mund të ndikojnë në funksionimin afatgjatë të infrastrukturës.

Inxhinier Gjeoteknik – jo më pak se 10 vite eksperiencë

Përvoja me jo më pak se 10 vite është e nevojshme pasi analiza e stabilitetit të terreneve, projektimi i mureve mbajtëse, përforcimi i themeleve dhe trajtimi i terreneve problematike kërkojnë njohuri të fituara nga shumë raste praktike. Eksperiencia ndihmon në identifikimin paraprak të risqeve dhe zgjedhjen e metodave më të përshtatshme të trajtimit.

Inxhinier Gjeodet / Topograf – jo më pak se 10 vite eksperiencë

Gabimet në të dhënat topografike mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të gjitha fazat e projektimit. Përvoja me jo më pak se 10 vite garanton aftësi në përdorimin e teknologjive moderne të matjes,

kontrollin e saktësisë së të dhënave dhe menaxhimin e rrjeteve gjeodezike. Një ekspert me përvojë minimizon rrezikun e pasaktësive që mund të sjellin ndryshime të kushtueshme gjatë projektimit.

Inxhinier Elektrik, Hidroteknik, Mekanik, Urbanist, Arkitekt – jo më pak se 7 vite eksperiencë

Kërkesa për jo më pak se 7 vite eksperiencë për këto profile konsiderohet proporcionale me kompleksitetin e detyrave që ata mbulojnë. Ky nivel eksperience siguron që specialistët kanë kaluar fazën e formimit profesional fillestar dhe kanë fituar njohuri të konsoliduara në projektim. Në këtë periudhë profesionale, ekspertët janë në gjendje të japin zgjidhje teknike të pavarura dhe të argumentuara.

Inxhinier Mjedis – jo më pak se 5 vite eksperiencë

Për projektimin e projekteve rrugore, Inxhinieri i mjedisit duhet të jetë në gjendje të kryejë vlerësime të ndikimit në mjedis dhe të propozojë masa në përputhje me legjislacionin. Një eksperiencë me jo më pak se 5 vite konsiderohet e mjaftueshme për të siguruar njohjen e procedurave ligjore, metodologjive të vlerësimit dhe praktikave më të mira për integrimin e kërkesave mjedisore në projektim.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **12 (dymbëdhjetë)** persona për muajin **Prill 2026**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Prill 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Prill 2026**.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Kërkesa për disponimin e një numri minimal prej 12 (dymbëdhjetë) punonjësish mbështetet në natyrën, kompleksitetin dhe volumet e shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës së projektimit.

Kriteri i vendosur për disponimin e fuqisë punëtore minimalisht **12 (dymbëdhjetë) persona** përcaktohet duke përlogaritur numrin e stafit të kërkuar në pikën 2.3.3 në këtë procedurë prokurimi për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate.

Objekti i kontratës përfshin disiplina të ndryshme teknike, si projektim rrugor, topografi, gjeologji, hidrologji, struktura, sinjalistikë dhe instalime elektrike, të cilat kërkojnë angazhimin e një stafi të mjaftueshëm teknik dhe mbështetës për të garantuar realizimin e projektit brenda afateve dhe standardeve të kërkuara.

Përcaktimi i këtij numri minimal synon të verifikojë kapacitetin organizativ dhe profesional të operatorit ekonomik për të përballuar njëkohësisht të gjitha fazat e studimit dhe projektimit, duke siguruar vijimësinë e punës, koordinimin ndërdisiplinor dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Kjo kërkesë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me dispozitat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, të cilat i japin të drejtë autoritetit kontraktor të kërkojë prova mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, përfshirë disponimin e burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës.

Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 12 punonjës të deklaruar për muajin Prill 2026, numër i konsideruar i nevojshëm dhe proporcional me objektin e prokurimit. Verifikimi i këtij kriteri kryhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga organet kompetente, konkretisht vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listëpagesave përkatëse, duke garantuar vërtetësinë e të dhënave të deklaruara.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: *Kërkesat e mësiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), sipas të cilit:*

“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e certifikatave të lartpërmendura ose ekuivalente, pasi objekti i kontratës lidhet me studim-projektimin e infrastrukturës rrugore, një veprimtari që kërkon zbatimin e proceseve të standardizuara të menaxhimit të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe sigurisë së trafikut rrugor.

Kërkesa për **SSH EN ISO 9001:2015** synon të garantojë që operatori ekonomik disponon procedura të konsoliduara për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë gjatë hartimit, verifikimit dhe koordinimit të dokumentacionit teknik të projektit.

Kërkesa për **SSH EN ISO 14001:2015** lidhet me nevojën për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore që mund të rrjedhin nga zgjidhjet e propozuara në projektim, duke siguruar respektimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi.

Kërkesa për **SSH EN ISO 45001:2023** garanton që operatori ekonomik zbaton sisteme të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, të nevojshme për aktivitetet e rilevimit në terren, inspektimeve, studimeve gjeologjike, gjeodezike dhe veprimtarive të tjera të lidhura me realizimin e projektit.

Kërkesa për **SSH EN ISO 39001:2012** lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të kontratës, pasi projektimi i infrastrukturës rrugore duhet të orientohet drejt minimizimit të rreziqeve që ndikojnë në sigurinë e përdoruesve të rrugës dhe përmirësimit të performancës së sigurisë rrugore gjatë gjithë ciklit të projektimit.

Këto certifikime përbëjnë dëshmi të kapaciteteve organizative dhe procedurale të operatorit ekonomik dhe janë në përputhje me objektin, kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimeve që do të realizohen. Për rrjedhojë, kërkesa konsiderohet e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar duhet të disponojë certifikatat përkatëse në funksion të pjesës së kontratës që do të realizojë, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve të kërkuara për të gjitha shërbimet objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

❖ Termat e Referencës janë hartuar në mbështetje të legjislacionit në fuqi në fushën e projektimit dhe ndërtimit, si më poshtë vijon:

- Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar;
- VKM Nr. 628, datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, si dhe të

- VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”.

Kërkesat teknike dhe produktet e pritshme të projektimit janë përcaktuar në përputhje me standardet dhe rregullat teknike në fuqi për projektimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore, funksionalitetit të veprës, cilësisë së projektit dhe përputhshmërisë së tij me procedurat e oponencës teknike.